

Bli dhe digj

Faktorizimi i çmilitarizimit në prokurimin e municioneve

Hyrje

Në Evropën Juglindore shtetet po bëhen gjithnjë e më të vetëdijshëm për nevojën e çmilitarizimit të sigurt dhe efikas të rezervave të tepërta ekzistuese të municioneve të armëve të vogla dhe armëve të lehta. Disa shtete që marrin pjesë në iniciativën Përqasja rajonale për reduktimin e rezervave (Regional Approach to Stockpile Reduction – RASR) kanë tashmë një ide të qartë për municionet e tyre të tepërta dhe gjendjen e tyre përkatëse dhe kanë marrë vendimin për të asgjësuar një pjesë të tyre duke përdorur metoda të ndryshme çmilitarizimi¹ (Gobinet, 2011, f. 24–31).

Megjithatë, shtetet që çmilitarizojnë edhe *prokurojnë*: reforma në mbrojtje nënkupton shkatërrimin e rezervave të tepërta të municioneve, por kërkesat e standardizimit ose modernizimit në të njëjtën kohë kërkojnë prokurimin e municioneve bashkëkohore. Municionet, duke qenë se janë mallra të

kushtueshëm që kërkojnë procese të gjata prodhimi, shpesh prokurohen në sasi të mëdha për t'i paraprirë kërkesave eventuale të strukturës së sigurisë së një shteti.

Në thelb, prokurimi i municioneve është i ngjashëm me nënshkrimin e një police sigurimi për mbrojtjen kombëtare (Bevan, 2008, f. 56): një pjesë e madhe e atyre që prokurohen nuk do të përdoren kurrë përpara se t'i skadojë kohëzgjatja e ruajtjes. Ndaj municionet e blera të reja kanë gjasa që të kthehen në teprica problematike në të ardhmen nëse shtetet nuk i trajtojnë sfidat e ardhshme të çmilitarizimit në mënyrë proaktive dhe nëse nuk investojnë për planifikimin e menaxhimit të ciklit jetësor të rezervave.

Kjo Përmbledhje e shkurtër, e hartuar nga Sondazhi për Armët e Vogla (Small Arms Survey) në mbështetje të iniciativës RASR, ka si qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e shteteve pjesëmarrëse për kostot e ardhshme që duhet të mbulojnë për asgjësimin

e armëve dhe municioneve që ata blejnë sot.

Ajo gjithashtu parashtron mundësitë për uljen e kostove të çmilitarizimit në të ardhmen – duke përfshirë balancimin e kostove të asgjësimit në çmimin e blerjes dhe teknologjitë «projektim për çmilitarizim» (Design for Demil – DfD) – dhe ndikimin që mund të ketë kjo te shtetet që do të ruajnë teprica në të ardhmen.

Çështjet kryesore në këtë Përmbledhje të shkurtër janë si më poshtë:

- Municionet gjenerojnë kosto përgjatë gjithë ciklit të jetëgjatësisë së tyre: nga projektimi deri te blerja, ruajtja, mbikëqyrja dhe provat, trajtimi dhe përdorimi, si dhe ndoshta gjatë gjithë kohës deri në asgjësimin e municioneve. Kjo nënkupton se duhet miratuar një praktikë për «menaxhimin gjatë gjithë jetës» së municioneve.
- Politika të tilla si DfD-ja në Shtetet e Bashkuara kanë për qëllim të ulin



Predha artilerie që priten në një sharre industriale (majtas) dhe predha të prera që transportohen për heqjen e eksplozivit (djathtas). © NAMSA

kostot e çmilitarizimit që në «burim» duke influencuar mbi projektuesit dhe prodhuesit e municioneve që në fazat e hershme të ciklit jetësor të municioneve dhe që t'i detyrojnë ata të përfshijnë faktorët e çmilitarizimit në mënyrë që kur të vijë koha çmilitarizimi të jetë më i lehtë dhe më pak i kushtueshëm.

- Për shkak të kompleksitetit të municioneve bashkëkohore dhe evoluimit në fushën e industrisë së çmilitarizimit, ku kjo e fundit shpesh drejtohet nga legjislacioni mjedisor në ndryshim dhe nga praktikat më të mira industriale, parashikimi dhe planifikimi i buxhetit për kostot e çmilitarizimit në të ardhmen që në çmimin e blerjes së municioneve mbetet më tepër një dëshirë e porealizueshme.
- Ekzistojnë një sërë masash më «realiste», si mbikëqyrja dhe modernizimi i municioneve, gjë e cila i lejon një shteti që të ulë ndjeshëm shpenzimet gjatë gjithë ciklit jetësor të municioneve duke optimizuar momentin se kur një grup i caktuar municionesh duhet të asgjësohet.

- Në të njëjtën mënyrë, shtetet individuale mund të marrin një sërë masash për të planifikuar, kontrolluar dhe (akoma më mirë) të ulin kostot e çmilitarizimit në fazën e duhur të ciklit jetësor të municioneve. Këto masa përfshijnë nxjerrjen e kërkesave për propozime të përshtatura për industrinë e çmilitarizimit, modernizimin e logjistikës, dhe dhënien e prioritetit në mënyrë sistematike për artikujt e tepërt në kategoritë homogjene përgjatë gjithë ciklit jetësor të rezervave të municioneve.

Ulja e kostove të çmilitarizimit në fazën e projektimit


Projektuesit e municioneve tradicionalisht e kanë fokusuar zhvillimin dhe projektimin e produkteve të tyre te performanca dhe jo te lehtësia e çmilitarizimit në fund të ciklit jetësor të municioneve (Mescavage, 2010).

Kjo nuk ka qenë një çështje e rëndësishme kur shtetet përdornin teknikat tradicionale dhe më pak të ndërlikuara të asgjësimit, si djegia në

ambient të hapur (OB) ose detonimi në mjedis të hapur (OD) ose hedhja me shumicë të municioneve të tepërta, si p. sh. hedhja në det, për të cilat ndërtimi i municioneve nuk është një faktor kryesor.

Duke u përballur me ndalimet ndërkombëtare të hedhjes në det (IMO, n.d.), një regjim gjithnjë e më të shtrenguar të rregulloreve për mjedisin, me presionin publik mbi qeveritë për metoda të qëndrueshme të çmilitarizimit, me stoqet në rritje të municioneve të tepërta të pas luftës së ftohtë dhe buxhetet e kufizuara të qeverive, gjatë dy dekadave të fundit çmilitarizimi i ka shmangur në mënyrë progresive metodat OB/OD si metoda kryesore të asgjësimit. Nga industria dhe agjencitë e kërkimit janë zhvilluar teknika të reja, të cilat kanë si qëllim të kontrollojnë emetimet në atmosferë dhe të rrisin metodat e rikuperimit, të riciklimit dhe ripërdorimit (R3). Metodat R3 i ndajnë municionet deri në pjesët dhe përbërësit e tyre bazë të riciklueshëm, të cilët më pas mund të shiten për të kompensuar kostot e përpunimit dhe në këtë mënyrë të ulin

Figura 1 Menaxhimi i ciklit jetësor të municioneve



Burimi: Buckley, Suvari, and Deschambault (2009)

koston e përgjithshme të çmilitarizimit. Megjithatë, jo të gjitha municionet janë të përshtatshme për metodat R3 dhe në disa raste sasia që duhet çmilitarizuar nuk mjafton për të zhvilluar një linjë përpunimi industrial ekonomikisht të qëndrueshme².

Efikasiteti i këtyre operacioneve industriale të çmilitarizimit, ndër faktorët e tjerë, si p.sh. sasia dhe ritmi i çmilitarizimit, ndikohet ndjeshëm edhe nga *projekti* fillestar i municionit. Megjithatë, vetë projektimi i municioneve jo gjithmonë kontribuon në rikuperimin me kosto-efektivitet të materialeve për riciklim ose ripërdorim. Municionet që projektohen dhe blihen sot janë më të ndërlikuara se ato që po çmilitarizohen aktualisht. Ato mund të përfshijnë pjesë elektronike të ngulitura, eksplozivë me material lidhës plastik (PBX)³ dhe eksplozivët e lartë insensitivë. Këto modele municionesh mund të mos përshtaten me efikasitet me proceset aktuale të çmilitarizimit, duke paraqitur vështirësi të tjera gjatë çmontimit dhe si përfundim duke shtuar kohën dhe shpenzimet e operacioneve të çmilitarizimit. Kjo mund të kontribuojë në rritjen e koston së ciklit jetësor.

Për të ulur koston e ciklit jetësor të municioneve konvencionale (Figura 1), kuptohet që faktorët e çmilitarizimit duhet të përfshihen që në fazën e projektimit. Në nivelin global që lidhet me politikën, Udhëzimet teknike ndërkombëtare për municionet nga UNODA (UNODA, 2011a, f. v) deklarojnë se municionet duhet të çmilitarizohen ose të shkatërrohen në fazën e duhur të ciklit të tyre jetësor, por theksojnë gjithashtu rëndësinë e miratimit të një praktike për «menaxhimin gjatë gjithë jetës» duke u mbështetur nga raporti i vitit 2008 nga Grupi i ekspertëve qeveritarë të OKB-së (UNGA, 2008, Përmbledhje). Në një nivel më rajonal dhe teknik, Marrëveshja e Standardizimit (STANAG) 4315 dhe *Botimi për municionet e aleatëve (Allied Ordnance Publication) (AOP)*⁴⁶ përbëjnë bazat e praktikës së përdorur nga NATO për vlerësimin e municioneve gjatë gjithë jetës (Sharp, n.d.).

Kjo përfaqëse nuk është e re as për Ministrinë e Mbrojtjes (MM-të). Specialistët e municioneve prezantuan konceptin DfD në komunitetin e çmilitarizimit në mes të viteve 1990,

megjithatë qeveritë shpesh nuk kanë dashur t'i japin një hapësirë kostove të tija në ciklet e buxhetit të tyre⁴. Përveç kësaj vetëm MM-të e informuara, të cilat përmbajnë në stafin e tyre ekspertë të municioneve dhe të aftë për menaxhimin e avancuar të rezervave, i kanë pranuar konsiderimet DfD. Në vendet në tranzicion, MM-të tradicionalisht nuk e kanë pëlqyer një kontroll të tillë mbi modelin e municioneve që ato blejnë. Megjithatë, shumë MM tani në mënyrë të heshtur i pranojnë përfitimet e DfD dhe gjithnjë e më shumë aplikojnë më shumë konsiderimet e asgjësimit gjatë prokurimit⁵.

Duke shkuar një hap më tej, Departamenti i Mbrojtjes së SHBA-së ka hartuar një politikë DfD-je. Më 4 gusht 2008 zëvendëssekretari i mbrojtjes së SHBA-së për blerjen, teknologjinë dhe logjistikën, nënshkroi një memorandum politikash ku kërkohet që DfD-ja të implementohet në të gjitha Shërbimet e Përbashkëta. Memorandumi deklaron se «projektimi i sistemeve të mira trajton të gjithë aspektet e ciklit jetësor, përfshirë çmilitarizimin dhe asgjësimin në këto sisteme»; përcakton kërkesa specifike; dhe kërkon që të gjitha shërbimet «të përfshijnë në dokumentacionin e tyre të blerjes për të gjitha programet e municioneve konvencionale (ato që janë pezull dhe në të ardhmen) në mënyrë sesi ato parashikojnë t'i trajtojnë kërkesat e çmilitarizimit për modelin përgjatë projektimit të sistemit» (Young, 2008). Qëllimi i politikës është që të influencojë mbi projektuesit e municioneve që në fazat e hershme të ciklit jetësor të municioneve dhe t'i detyrojë ata që të përfshijnë konsiderimet e çmilitarizimit me «ndryshime me kosto të ulët që nuk ndikojnë në performancë» (Mescavage, 2010). Në mënyrë ideale, dokumentacioni i blerjes për municionet konvencionale duhet të përfshijë kërkesat e çmilitarizimit të modelit dhe një plan çmilitarizimi ku përshkruhen procedurat, proceset dhe teknologjitë që duhet të përdoren. DfD-ja është një qëllim kryesor strategjik i Planit strategjik të Grupit për Çmilitarizimin (Demilitarization Enterprise Strategic Plan), (PM Demilitarization, 2009, f. 4), ndërkohë që drejtori i programit Shërbime të Përbashkëta aktualisht po përfundon një manual udhëzues për DfD-në që përfshin një seksion mbi

konsiderimet e projektimit dhe praktikat më të mira (Mescavage, 2010).

DfD nuk është një zgjidhje gjithëpërfshirëse për të trajtuar sfidat e çmilitarizimit në të ardhmen dhe jo çdo lloj municioni mund të përfitojë prej saj. Disa artikuj në një inventar blihen në sasi shumë të vogla dhe kërkojnë teknika të thjeshta asgjësimi. Disa të tjerëve mund të mos u nevojitet asnjëherë një proces formal asgjësimi, sepse përdoren që të gjitha në stërvitje ose operacione. Planifikimi i asgjësimit duhet të merret në kontekst dhe DfD-ja duhet të përdoret në mënyrë proporcionale. Vetë procesi i DfD-së kërkon kohë dhe burime dhe nuk duhet të aplikohet pa bërë dallime nga frika e zhvillimit të teknikave për të cilat nuk ka sasi të mjaftueshme municionesh për të përpunuar, ose më keq akoma, nga frika e komprometimit në mënyrë të panevojshme të projektit ose të koston së municioneve të reja⁶.

Megjithatë, DfD-ja mund të ketë pasoja indirekte për të gjithë palët e përfshira në çmilitarizim dhe për specialistët e prokurimeve, përfshirë ata në Evropën Juglindore. Për shembull, ajo konsiderohet si nxitëse e zhvillimit të sistemeve të municioneve të përgjegjshme për mjedisin që përfshijnë heqjen e materialeve potencialisht të rrezikshme për mjedisin për të ulur ose shmangur nevojën për ndreqjen e poligoneve të qitjes (Towndrow, 2009). Është e kuptueshme se në një të ardhme të afërt një STANAG i ri i NATO-s do t'i përfshijë konsiderimet e DfD në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes për të gjithë artikujt e rinj ose të modifikuar të municioneve (përfshirë municionet insensitive dhe energjetike në të ardhmen), që nga faza e konceptimit deri te pranimi final i artikullit të përfunduar. Në mënyrë indirekte, ajo duhet t'i nxisë specialistët e prokurimit që të rimarrin në konsideratë ose t'i riorientojnë politikën e tyre të prokurimit ashtu siç duhet.

Përfshirja e kostove të çmilitarizimit në fazën e prokurimit

Kur blen municionet, personeli i prokurimit duhet të marrë në konsideratë një sërë shpenzimesh që bëhen, si p.sh. koston e dorëzimit, përveç koston fillestare të vetë municioneve.

Pasi blihen, municionet do të sjellin kosto të tjera shtesë «jo të drejtpërdrejta» gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor, si p.sh. kostoja e ruajtjes, e provës, e mbikëqyrjes, e mirëmbajtjes, riparimit dhe kostot e sigurisë, të cilat do t'i shtohen kostove fillestare të prokurimit. Nëse municionet nuk përdoren pas disa vitesh, analizat mund të dalin në përfundimin se asgjësimi është një zgjidhje më e lirë sesa ruajta e vazhdueshme pasi municionet kanë arritur fundin e jetëgjatësisë së tyre të përdorimit. Nëse shteti zgjedh që të shkatërrojë ose çmilitarizojë municionet, atëherë kjo do të përbëjë një tjetër shpenzim «jo të drejtpërdrejta», i cili zakonisht nuk është marrë në konsideratë nga blerësit fillestarë të municioneve.

Në këtë mënyrë, çmilitarizimi mund të konsiderohen si një shërbim për të cilin autoritetet kombëtare dhe organizatat ndërkombëtare janë të gatshme të paguajnë nëse duhet të ruajnë sigurinë e rezervave të municioneve të tyre. Për këtë arsye, teorikisht mund të përfytyrohet një sistem ku kostot që shkaktohen si pasojë e çmilitarizimit të municioneve të parashikohen që në fazat përpara blerjes dhe të parashikohen në buxhet që në blerjen fillestare të municioneve. Mund të diskutohet se kompanitë në sektorin e mbrojtjes që shesin municione për qeveritë mund ta përfshijnë këtë shërbim në çmimin e blerjes së municioneve, duke krijuar një fond besimi për të mbuluar kostot e ardhshme të çmilitarizimit në fazat e mëvonshme.

Ky skenar ideal është i vështirë të arrihet në realitet për një sërë arsyesh:

- Në shumë Ministri Mbrojtjeje, buxhetet dhe/ose departamentet përgjegjëse për prokurimin fillestar, mbështetjen dhe asgjësimin janë të ndara, duke e bërë të vështirë arritjen e një përjasjeje koherente. Gjatë viteve të fundit kjo është bërë më pak shqetësuese, sepse MM-të e mirinformuara përdorin një përjasje që përfshin gjithë jetëgjatësinë⁷.

- Gjithnjë e më shumë municionet po blihen me karakteristika standarde, duke mos i lënë mundësi klientit që t'i përfshijë kërkesat specifike të DfD-së në modelin e tij pa ndonjë vonesë ose kosto të konsiderueshme. Në të njëjtën mënyrë, vendet që i pranojnë municionet si dhurata apo transferime, kanë influencë të kufizuar mbi modelin e tyre⁸.
- Municionet blihen për t'u përdorur në konflikte ose stërvitje. Qeveritë nuk i blejnë ato me qëllimin që t'i mbajnë në ruajtje për 20–30 vjet pastaj në fund t'i çmilitarizojnë, edhe pse kjo mund të jetë ajo që ndodh me shumicën e rezervave. Shtimi i kostove të çmilitarizimit në të ardhmen në kostot e prokurimit fillestar të municioneve është si t'i kërkosh blerësit që të paguajë për një shërbim që mund të mos nevojitet kurrë, sepse disa nga municionet e blera do të përdoren dhe në përfundim do t'i kushtojnë blerësit më shumë (d.m.th. duke paguar për çmilitarizimin që nuk ndodh kurrë). Me qëllim për ta bindur klientin që të paguajë për çmilitarizimin që në fazat e para, p.sh. gjatë blerjes fillestare të municioneve, kompanitë në sektorin e mbrojtjes duhet të propozojnë një sërë opsionesh të ndërlikuara të kontratës.
- Afati kohor ndërmjet prodhimit të municioneve dhe asgjësimit të tyre shpesh është 20 deri në 30 vjet. Kompanitë në sektorin e mbrojtjes mund të pësojnë ndryshime drastike gjatë kësaj periudhe kohore. Një qeveri që blen municione nga një kompani dhe në të njëjtën kohë kontraktin kompaninë për çmilitarizimin e ardhshëm të këtyre municioneve pas 20 ose 30 vjetësh, përballet me mundësinë për të punuar me një kompani që është shumë ndryshe nga ajo që ka nënshkruar kontratën fillestare. Nëse kompania ose divizioni i saj i çmilitarizimit nuk ekziston më, atëherë blerësi nuk do të jetë në gjendje që të përdorë një shërbim që

e ka paguar shumë kohë më parë. Në këtë rast, duhet të kontraktohet një kompani e re çmilitarizimi nëpërmjet tenderëve të kushtueshëm. Kjo si përfundim rrit kostot e ciklit jetësor të municioneve.

- Çmimi për vetë shërbimin e çmilitarizimit është i vështirë për t'u përcaktuar 20 ose 30 vjet përpara, për shkak të rolit që luan logjistika. Kostot e përfshira në sigurimin, ruajtjen dhe transportimin e municioneve, ku ky i fundit shpesh bëhet përmes disa shteteve, mund të përbëjnë deri në 50 për qind të shumës totale të një kontrate çmilitarizimi. Logjistika nuk është biznesi kryesor i kompanive të çmilitarizimit industrial dhe kjo ua vështirëson punën për të parashikuar çmime fikse për këtë shërbim. Përveç kësaj, as prodhuesi dhe as klienti nuk mund të parashikojnë se nga ku duhet të merren municionet e përcaktuara për t'u çmilitarizuar pas 20 ose 30 vjetësh, dhe ata as nuk mund ta verifikojnë gjendjen fizike të municioneve dhe ambalazhit të tyre kaq para kohe.
- Jo të gjithë prodhuesit e municioneve menaxhojnë të gjithë ciklin jetësor të municioneve. Ata që nuk e bëjnë këtë, shpesh bashkëpunojnë me nënkontraktorë për të përmbyshur nevojat e tyre të çmilitarizimit. Kompleksiteti i marrëveshjes së tyre kontraktuale dhe fakti i thjeshtë se kjo shton ndërmjetësit ndërmjet blerësit dhe ofruesit të shërbimit në përfundim do të rrisë çmimin e çmilitarizimit.
- Me qëllim për t'i fituar tenderët, kompanitë e çmilitarizimit duhet t'i standardizojnë shërbimet e tyre sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në përputhje me legjislacionet kombëtare të shteteve me të cilat ata bëjnë biznes. Për të qenë në përputhje me rregulloret mjedisore dhe për të plotësuar kërkesat e klientëve për një përdorim në rritje të metodave R3, industrisë së çmilitarizimit i është kërkuar gjithnjë e më shumë që të përdorë pajisje të shtrenjta për kontrollin e ndotjes, p. sh. për të ulur emetimet në atmosferë nga djegia. Këto metoda janë të ndërlikuara dhe të kushtueshme për t'u ngritur, zhvilluar dhe për

Teorikisht, kompanitë në sektorin e mbrojtjes mund të imagjinojnë një sistem prokurimi për municionet që parashikon kostot e çmilitarizimit të produkteve të tyre në të ardhmen.

t'u përdorur. Vetë municionet me kalimin e viteve shpesh bëhen më të ndërlikuara për t'u çmilitarizuar. Komplexiteti i rritur rezulton në rritje të kostove dhe «fitime margjinale» më të vogla (Raftery, 2008, f. 40). Kjo nënkupton se euroja apo dollari që përdoret nesër për çmilitarizim do të ketë vlerë më të ulët për sa i përket numrit të artikujve të çmilitarizuar.

Ulja e kostove të çmilitarizimit: zgjatja e jetëgjatësisë së municioneve nëpërmjet mbikëqyrjes

Veçoritë kimike, fizike, elektrike dhe mekanike të municioneve degradojnë përgjatë ciklit të tyre jetësor. Edhe faktorët mjedisorë përshpejtojnë procesin e vjetërimit. Municionet janë projektuar për t'u përdorur brenda kufijve të caktuar klimatikë, përndryshe jetëgjatësia e tyre e përdorimit do të ulej ndjeshëm. Ndikimet e motit, rrezatimit të drejtpërdrejtë të diellit, ndryshimeve ditore të temperaturës dhe lagështia mund të përkeqësojnë me shpejtësi performancën dhe sigurinë e eksplozivëve. Në disa raste, municionet mund të dalin shumë shpejt jashtë përdorimit dhe të bëhen të rrezikshëm për t'u përdorur. Eksplozivët e ekspozuar ndaj temperaturave të rritura mund të rrjedhin⁹ dhe propelantët¹⁰ mund të dekompozohen. Mbushjet jo shpërthyesë të disa municioneve, si fosfori i bardhë¹¹, mund të shkrijnë kur i nënshtrohet temperaturave shumë të larta, duke ndryshuar kështu qendrën e gravitetit të predhës pas ngurtësimit, duke ndryshuar dhe balistikën e tyre. Nëse nuk monitorohen, degradimi i municionit mund ta kthejë atë në të paparashikueshëm, madje dhe të rrezikshëm, për të qëlluar, përdorur, ruajtur dhe transportuar.

Mbikëqyrja e municioneve¹² përshkruhet si

metoda sistematike e vlerësimit të veçorive, karakteristikave dhe aftësive të performancës së municioneve përgjatë gjithë ciklit jetësor të tij me qëllim për të vlerësuar besueshmërinë, sigurinë dhe efikasitetin operacional të stoqeve dhe për të siguruar të

dhëna në mbështetje të rivlerësimit të jetëgjatësisë (UNODA, 2011b, f. 30).

Procesi përfshin një bateri testesh funksionale të projektuara për të identifikuar besueshmërinë e rezervave të municionit, për të siguruar gatishmërinë në kohë lufte dhe për të veçuar pjesët mekanike që kanë probleme. Inspektimet vizuale verifikojnë shkallën e dëmtimit ose përkeqësimit fizik të kampionit të municionit dhe të ambalazhit të tij logjistik. Testet e stabilitetit kimik (p.sh. për propelantët dhe ngarkesat shtytëse¹³) dhe testet e inspektimit radiografik (me rreze X) (p.sh. për mbushjet me «eksploziv të lartë») kryhen në laboratorë me kampionë të zgjedhur rastësisht për të përcaktuar gjendjen e përbërësve të tyre. Duke vlerësuar karakteristikat funksionale dhe jo funksionale të kampionëve përfaqësues të rezervave të municioneve, mbikëqyrja e municioneve lejon marrjen e vendimeve në kohën e duhur nëse mund të zgjatet kohëzgjatja e konservimit ose nëse municionet dhe përbërësit e tyre kërkojnë mirëmbajtje, çmontim ose asgjësim. Nëse merren masat e duhura, operacionet e mirëmbajtjes mund të kryhen në depo¹⁴, gjë e cila ul ndjeshëm kostot e logjistikës. Nëse bëhet siç duhet, mbikëqyrja e municioneve përmirëson sigurinë deri në fund të jetëgjatësisë së municioneve dhe mund të ulë koston e përgjithshme të ciklit jetësor të tyre (UNODA, 2011c, f. 2).

Mosha e municioneve duhet të jetë një element për t'u pasur kujdes, por kjo nuk do të thotë se municionet e vjetra nuk mund të përdoren. Mbikëqyrja e municioneve, gjë që u lejon specialistëve të gjurmojnë moshën e stokut, ka përfitime edhe për rezervat më të vjetra që ruhen në kushte optimale. Në këtë mënyrë, mbikëqyrja e duhur e municioneve mund të shtyjë nevojën e një qeverie për të prokuruar municione të reja. Autoritetet mund të krijojnë një politikë «rotacioni» me anë të së cilës stoqet e municioneve më të vjetra, por krejtësisht të përdorshëm, t'u shpërndahen ushtarëve në terren dhe të mos mbesin në magazina për një kohë të papërcaktuar (US GAO, 1996, f. 28).

Në përfundim, modernizimi i municioneve është një alternativë efektive në kosto për prokurimin

e municioneve të reja. Duke zëvendësuar disa përbërës, performanca, siguria dhe besueshmëria e municioneve ekzistuese mund të rivendoset ose edhe të përmirësohet. Duke i zëvendësuar eksplozivët me mbushje inerte ose piroteknika të veçanta (me efekte drite, «shpërthimi» dhe tymi), municionet e luftimit mund të konvertohen në mënyrë të suksesshme në municione për stërvitje.

Ulja e kostove gjatë çmilitarizimit

Në fazën e fundit të spektrit të jetëgjatësisë së municioneve, vendimi për të çmilitarizuar duhet të përfshijë një sërë faktorësh që mund të ndikojnë në koston dhe efikasitetin e procesit.

Planifikimi i metodës së duhur të çmilitarizimit

Siç u përmend më lart, municionet i nënshtrohen degradimit kimik dhe mekanik përgjatë jetës së tyre, duke i bërë ata të pasigurt për t'u përdorur ose për t'u ruajtur. Kur vjen koha që municionet të shkatërrohen, është shumë vonë për të menduar një plan asgjësimi. Rreziqet për aksidente rriten ndërkohë që autoritetet përpiqen të vendosin për një mënyrë për të vazhduar. Edhe pse mund të kalojnë shumë vite deri kur të bëhet asgjësimi dhe teknologjitë ndërkohë mund të kenë ndryshuar, pasja e një plani të gatshëm do të ndihmonte në reduktimin e kohës dhe të parave që nevojiten për veprimet e asgjësimit. Është më e lehtë të ndryshosh një plan ekzistues sesa të hartosh një nga fillimi, sidomos kur koha e artikujve ka skaduar dhe kjo mund të shkaktojë rreziqe për sigurinë gjatë transportimit ose ruajtjes. Planifikimi paraprak i një procesi çmilitarizimi nënkupton se shteti mundet që:

- t'u japë përparësi municioneve për sa i përket sasisë, llojit, gjendjes dhe vështirësisë së përpunimit; dhe
- të marrë një sërë vendimesh paraprake në lidhje me kapacitetin e tij të çmilitarizimit brenda vendit dhe gatishmërinë e tij për t'i kontraktuar disa pjesë të procesit¹⁵.

Proceset e çmilitarizimit përdorin dy metoda kryesore: OB/OD dhe çmilitarizimin industrial. Shumica e programeve të sigurisë fizike dhe menaxhimit të rezervave përfshijnë një kombinim të të dyjave dhe secila metodë ka avantazhet dhe disavantazhet e saj (shihni King and Diaz, 2011, f. 37-42). Vendimi për të zgjedhur një teknikë të veçantë bazohet në vlerësimet për koston, sigurinë dhe mjedisin, në disponueshmërinë e kontraktorit, logjistikës, llojin e municioneve që do të shkatërrohet, gjendjen fizike ose kimike të municioneve dhe vlerën e materialeve të përfutuara.

Teknikat OB/OD tradicionalisht janë përdorur për asgjësimin e municioneve jashtë përdorimi, që janë të vjetra dhe të tepërta. Gjatë viteve të fundit këto teknika nuk preferohen nga shumë praktikantë të çmilitarizimit, për të cilët OB/OD-të janë burime potenciale për ndotjen e pakontrolluar të dheut, ujërave nëntokësore dhe ajrit. Kundërshtuesit e OB/OD-ve gjithashtu vënë në dukje rreziqet e shkaktuara nga valët tronditëse, fragmentet

e shpërndara dhe copat¹⁶ e tepërta që hedhin shpërthimet në një zonë të gjerë. OB/OD-të gjithashtu konsiderohen se prishin më tepër burime, meqë shumë pak materiale që dalin prej tyre mund të riciklohen. I gjithë procesi në tërësi ka shumë punë dhe mund të jetë i ngadaltë në rajone me popullsi të madhe si shumica e Evropës, ku kufizimet e eksplozivëve janë të ulëta (Courtney-Green, 2009).

Mbi një sasi të caktuar, OB/OD-të mund të mos jenë aq efikase në kosto sa çmilitarizimi industrial për disa lloje municionesh. Në Konferencën e Berlinit për Shkatërrimin e Municioneve Thërrmuese, një përfaqësues i Kanadasë vuri në dukje se, bazuar në përvojën e shtetit të tij në mbështetje të projekteve të shkatërrimit të minave anti-njeri, nëse do të shkatërroheshin afërsisht një milion mina, do të ishte më pak e kushtueshme që të përdreshin teknologji të tjera (MacBride, 2009, f. 42). Në përfundim, OB/OD-ja mund të jetë një zgjidhje e zbatueshme për asgjësimin e eksplozivëve të fuqishëm, por ajo është një teknikë më pak e përshtatshme për

municionet që përmbajnë materiale më pak energjike, p.sh., municionet e kundërmasave ose municionet me rrezikshmëri të ulët (këto të fundit janë të mbushura me eksplozivë të lartë insensitivë).

Megjithatë, komuniteti i çmilitarizimit aktualisht është i përçarë nga argumenti mjedisor, ku mbështetësit i mbrojnë operacionet OB/OD të kryera në mënyrë profesionale si një proces shumë efikas dhe me ndikime mjedisore të papërfillshme. OB/OD-të mbesin zgjidhjet e vetme praktike dhe pragmatike nëse stoqet janë shumë të rrezikshme për t'u zhvendosur ose nëse duhet të arrihen ekonomi të ulëta të shkallës brenda rezervave kombëtare. Shumica e forcave të armatosura, përfshirë edhe ato brenda NATO-s, janë të interesuara që ta ruajnë OB/OD-në si një metodë të vlefshme dhe «institucionale» për asgjësimin e municioneve dhe eksplozivëve. Ndikimi në mjedis mund të menaxhohet duke zgjedhur me kujdes vendin ku do të bëhet shkatërrimi dhe materialet që do të shkatërrohen, duke monitoruar



Zbrazja e predhave të mbushura me TNT. © Expal Bulgaria

vazhdimisht shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë të shesheve të shkatërrimit. Shkarkimet në zonën lokale të tokës nga OD-ja shpesh mund të zvogëlohen ose të ndalohen duke izoluar tokën për të ndaluar rrjedhjen e ujit ose duke përdorur govata djegieje për propelantët për të ndaluar përhapjen e materialit gjatë djegies. Në Kanada, për shembull, kryhen studime për mbledhjen e kampionëve të dheut dhe hidrogeologjikë në sheshin e shkatërrimit pranë Depove të Armatimit të Forcave Kanadeze në Dundurn për të matur përqendrimet e materialeve energjetike dhe metaleve të rënda në kampionët e ujit dhe të dheut (Park, Eng, and Garrard, 2011, parag. 5.5).

Çmilitarizimi industrial përfshin përdorimin e teknologjive të ndryshme për të djegur, shkrirë, prerë, shtypur dhe çmontuar municionet deri në pjesët dhe elementët e tyre përbërës. Për të ulur kostot e çmilitarizimit dhe për të kompensuar çmimin e transportit dhe përpunimit, shumica e kontraktorëve rrisin në maksimum rikuperimin e materialeve me vlerë në treg (Towndrow, 2009, parag. 26). Proceset e sofistikuar industriale të R3 përfshijnë riciklimin efikas të këtyre komponentëve dhe materialeve. Çmilitarizimi industrial kërkon investime fillestare të konsiderueshme, por kur impianti të jetë ndërtuar dhe makineritë të jenë instaluar, proceset mund të vihen në funksionim pa ndërprerje nga shumë pak njerëz. Shteti mund të kontrollojë zbatimin e punës gjatë të gjitha fazave të procesit të shkatërrimit: shumica e vendeve ia delegojnë këtë detyrë përfaqësuesit të qeverisë për garantimin e cilësisë në vendin mikpritës ku kryhet çmilitarizimi. Elementet sensitive të municioneve, p.sh. pjesa e deformuar e udhëzuesit të një predhe MANPADS¹⁷ mund të ndahet më vete për të dëshmuar se çmilitarizimi është kryer me korrektësi. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se disa teknika të çmilitarizimit industrial çojnë në prodhimin e mbetjeve të rrezikshme, të cilat në vetvete duhet të shkatërrohen ose të asgjësohen në një mënyrë jo të dëmshme për mjedisin. Përveç këtyre, shumë artikuj janë ose shumë të vegjël e shumë të ndërlikuar, ose nuk sjellin

Shtetet rrallë e kanë kapacitetin e brendshëm për të çmilitarizuar të gjitha rezervat e tepërta të forcave të sigurisë.

përfitime të mjaftueshme për t'u ricikluar me efikasitet (Shoqata e Ushtrisë së SHBA-së 2008, f. 4). Autoritetet kombëtare duhet të jenë të ndërgjegjshme se zhvillimi qoftë edhe i proceseve të thjeshta të çmilitarizimit ose shkatërrimit mund të kërkojë kohë. Kjo kohë e kërkuar duhet të përfshihet në procesin e planifikimit dhe përgatitjes së çmilitarizimit.

Kontraktimi i kompanive private të çmilitarizimit

Shtetet rrallë e kanë kapacitetin e brendshëm për të çmilitarizuar të gjitha rezervat e tepërta të forcave të sigurisë. Në vend të kësaj, zgjidhja mund të jetë drejtimi i kërkesave për propozime (RfP) në industrinë private të çmilitarizimit që të trajtojnë çmontimin dhe demolimin e municioneve dhe eksplozivëve.

Pas ndalimit të hedhjes në detet e thella si teknikë asgjësimi nga Konventa e Londrës e vitit 1972 për Parandalimin e ndotjes së deteve nga hedhja e mbeturinave dhe materialeve të tjera (IMO, n.d.), Evropa ka zhvilluar një industri moderne dhe të mirë-rregulluar për çmilitarizimin e municioneve për asgjësimin e rezervave të tepërta. Që atëherë, kompanitë private kanë çmilitarizuar stoqe të mëdha të të gjitha llojeve të municioneve – armë të vogla, piroteknike, propelantë, mortaja, artileri, bomba avionësh, predha, raketa dhe kundërmasa – sipas rregullave normale të ofertimit konkurrues.

Kompanitë private të çmilitarizimit kanë përvojë të konsiderueshme në aplikimin dhe zhvillimin e rregulloreve për mallrat e rrezikshëm dhe mbetjet e rrezikshme¹⁸, të cilat zbatohen për transportimin e municioneve dhe eksplozivëve të përcaktuara për çmilitarizim. Kontraktimi i një kompanie të kualifikuar çmilitarizimi mund të kursejë kohë dhe kostot administrative nëse plani i çmilitarizimit përfshin transportin e konsiderueshëm dhe logjistikën e jashtme.

RfP-të publikohen nga autoritetet kombëtare ose koordinohet nga disa organizata ndërkombëtare si Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Furnizim (NATO Maintenance and Supply Agency – NAMSA) dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në emër të një shteti të caktuar ose një grupi të caktuar shtetesh¹⁹. Më pas, pala që paraqet kërkesën vlerëson propozimet e ndryshme dhe shpall si fituese të tenderit/tenderëve kompaninë/të e përzgjedhura të çmilitarizimit, zgjidhja e të cilave trajton në mënyrën më të mirë, për sa i përket vlerës, kërkesat e përcaktuara në RfP. Gjatë procesit, konsiderimet e kostos hyjnë në lojë në një sërë fushash.

Përshtatja e tenderëve sipas nevojave

Firmat e çmilitarizimit konkurrojnë për pjesën e tyre në treg. Ato përpiqen të rrisin përfitimet, të investojnë në teknologji të reja çmilitarizimi dhe të ruajnë bazën e klientëve të tyre. Kjo është një nxitje e fuqishme për të ulur kostot e çmilitarizimit dhe zgjedhja e llojit të duhur të tenderit është kritike. Tre janë llojet bazë të tenderit dhe secili prej tyre u jep nivele të ndryshme rëndësie kriterëve të kostos.

1. Lloji i parë kombinon aspektet teknike dhe financiare, por vlerëson ofertat sipas një liste renditëse të kriterëve. Çdo kriteri të paracaktuar i caktohet një «peshë» e caktuar rëndësie, duke i dhënë një numër pikësh secilit prej propozimeve. Për shembull, Administrata e Materialeve të Mbrojtjes në Suedi (Swedish Defence Materiel Administration) i vlerëson ofertat mbi këtë bazë. Kriteri me peshën më të madhe të rëndësisë (60 për qind) është riciklimi i eksplozivëve; kriteri i çmimit ka një peshë rëndësie prej vetëm 40 për qind. Për ofertat me vlerë të njëjtë, kriteret peshohen dhe vlerësohen sipas rendit të mëposhtëm: riciklimi i materialeve, riciklimi i energjisë me pastrimin

- e gazit të shkarkimit dhe hedhjen e mbetjeve (Swedish Defence Materiel Administration, 2010, f. 6).
2. Lloji i dytë i tenderit përfshin një sistem me «dy zarfe» në të cilin oferta teknike është ajo që vlerësohet e para (zarfi i parë). Ofertat klasifikohen përpara se të hapet oferta financiare (zarfi i dytë). Kjo siguron që çmimi të mos ndikojë në vlerësimin teknik të propozimit. Nëse propozimi teknik vlerësohet si e papajtueshëm, zarfi i çmimit do t'i kthehet ofertuesit i pahapur (NAMSA, 2009, parag. 5.2.1). Kjo u lejon autoriteteve që të përzgjedhin një ofertues dhe të sigurohen se ai është në përputhje me propozimin në aspektin teknik, ekonomik dhe kontraktual. Gjatë vlerësimit të propozimeve me qëllim përzgjedhjen e propozimit më ekonomik, konsiderata e duhur i jepet çmimit, kohës së furnizimit dhe kapacitetit teknik.
 3. Një opsion i tretë është ai ku çmimi është kriteri i vetëm i shpalljes së

fituesit, d.m.th. kontrata i jepet ofertuesit me çmimin më të ulët, por që përmbush edhe kushtet e tjera.

Është e rëndësishme që ky konkurrim të bëhet brenda kuadrit të cilësisë. Organizatat ndërkombëtare si NAMSA dhe Bashkimi Evropian (BE) ta sigurojnë këtë cilësi në deklaratat e tyre të dokumentacionit për ofertuesit duke kërkuar që kontraktorët të kenë në funksion sisteme të certifikuara për menaxhimin e cilësisë dhe të mjedisit ose që të plotësojnë kërkesat specifike në lidhje me kapacitetin e sistemit të kontrollit të ndotjes të shoqëruara me një furrë djegëse. Standarde të tilla mund të përfshijnë, për shembull:

- standardet për menaxhimin e cilësisë ISO 9001;
- standardet për menaxhimin e mjedisit ISO 14001;
- AQAP 2130²⁰; dhe
- një ose më shumë rregullore, p.sh. Direktiva e BE-së për Djegjen e Mbetjeve 2000/76/EC (EU, 2000).

NAMSA lehtëson procesin duke koordinuar ofertat nga industritë e çmilitarizimit në shtetet anëtare të NATO-s sipas rregullave normale konkurruese të ofertimit. Procesi i ofertimit është i hapur për ofertuesit e kualifikuar, ofertat e vulosura të të cilëve hapen në publik dhe fituesi shpallet mbi bazën e pajtueshmërisë teknike dhe çmimit më të ulët. Administratat kombëtare nuk kanë pse të shqetësohen për të krijuar «lista të shkurtra» të furnizuesve që i janë përgjigjur lajmërimit duke shprehur interes për të paraqitur ofertat dhe që kanë plotësuar një pyetësor para-kualifikimi për të treguar se ata kanë përvojën dhe burimet e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e mundësisë së prokurimit.

Për çdo rast, qeveria ose organizata ndërkombëtare duhet ta refuzojë një ofertë nëse ofertuesi në thelb dështon të dorëzojë informacionin e kërkuar në lidhje me kushtet elementare, si p.sh. siguria ose përshkrimi teknik i proceseve.



Bishta mortaje 120 mm në ULP Mjekës në Shqipëri. © NAMSA

Pronësia e materialit të ricikluar

Kompanitë e çmilitarizimit nuk do të kenë pronësi mbi municionet derisa ata të dorëzojnë një certifikatë të asgjësimit të tyre. Deklarata e punës së NAMSAs përcakton, për shembull, që në përputhje me rregulloret e vendit, forcat e armatosura të vendit mbeten pronare të municioneve. Pronari fillestar i municioneve mund të monitorojë shkatërrimin e tyre ose mund t'ia delegojë verifikimin një përfaqësuesi të qeverisë për garantimin e cilësisë (GQAR).

Pas çmilitarizimit, pronësia e materialit që mbetet i kalon kontraktorit. Certifikata e çmilitarizimit, e nënshkruar ligjërisht nga GQAR, do të konsiderohet si provë e mjaftueshme për transferimin e pronës nga forcat e armatosura të një vendi te kontraktori.

Megjithatë, ky transferim i pronës nuk është sistematik. Autoritetet kombëtare mund të kërkojnë pronësinë e çdo materiali të ricikluar, si skrap i metaleve dhe mbetjet eksplozive, dhe të vendosin nëse duan ose jo t'i shkatërrojnë ato ose t'i shesin për të financuar programe të tjera çmilitarizimi në të ardhmen. Disa mbushje eksplozive të municioneve mund të jenë të dobishme për industrinë komerciale të eksplozivëve; skrap i çelikut ka gjithmonë kërkesa.

Masat e qeverisë për të ulur kostot e çmilitarizimit

Pasi të jetë hartuar një plan çmilitarizimi ose pasi të jetë kontraktuar një kompani, qeveria mund të marrë një sërë masash për të ulur kostot e çmilitarizimit.

- Siç citohet edhe më lart, logjistika dhe transporti mund të përbëjnë deri në 50 për qind të kostos së një kontrate çmilitarizimi. Ky shërbim pothuajse gjithmonë i nënkontraktohet agjencive profesioniste të transportit, sepse logjistika nuk është biznesi kryesor i kompanive të çmilitarizimit industrial. Optimizimi i vëllimit të municioneve ose pesha neto e eksplozivëve dhe ambalazhi i përgjithshëm përpara transportit do të ulnin kostot e transportit. Ose më mirë akoma, nëse logjistika e transportimit të municioneve do t'i caktohej forcave të armatosura të

një vendi, kjo do të ulte ndjeshëm kostot e kontratës.

- Duhet të dorëzohen RfP të sakta dhe gjithëpërfshirëse që pasqyrojnë gjendjen dhe sasinë e saktë të municioneve që duhen çmilitarizuar. Shumë shpesh, kërkimet për municionet bëhen vetëm kur është shpallur fituesi i kontratës ose kur municionet janë në depon e impiantit të çmilitarizimit. Ndonjëherë municionet nuk janë në ambalazhin e tyre origjinal të logjistikës dhe janë në gjendje aq të keqe sa duhet të krijohen makineri të reja dhe të zbatohen udhëzime të reja për sigurinë. Kur nuk njihet gjendja e municioneve, kostoja e çmilitarizimit do të rritet.
- Qëllimi duhet të jenë ekonomitë e shkallës dhe lotet homogjene të municioneve. Uzinat e çmilitarizimit duhet të investojnë fonde për të bërë kërkime, zhvillime ose për të vendosur pajisje të reja në linjat e çmilitarizimit me qëllim përbushjen e kërkesave të kontratave të ndryshme. Në të njëjtën kohë shpenzohen shumë fonde për punën e specializuar dhe personelin e kualifikuar. Shpërndarja e këtyre shpenzimeve mbi një sasi të madhe municioni homogjen i lejon uzinës që të optimizojë procesin e prodhimit, të ulë vonesat gjatë procesit dhe si përfundim të ulë kostot. Planifikimi i kontratës për disa vjet do të çojë në kursime të mëtejshme për klientin, sepse investimet e bëra për makineri shumë automatike mund të kompensohen.

Për rrjedhojë, autoritetet kombëtare mund të duan të bashkëpunojnë me shtete të tjera me qëllim për të arritur ekonomi më të mëdha të shkallës dhe në këtë mënyrë dhe një çmilitarizim me kosto më efektive. Teorikisht, municionet nga disa shtete mund të trajtohen brenda një kontrate të vetme më të madhe duke çuar në ulje të kostos për shtetet individuale.

Autoritetet kombëtare mund të duan të bashkëpunojnë me shtete të tjera me qëllim për të arritur ekonomi më të mëdha të shkallës dhe në këtë mënyrë dhe një çmilitarizim me kosto më efektive.

Bashkimi i burimeve dhe ndarja e përbashkët e kostove po bëhet një praktikë e zakonshme në fushën e prokurimit të municioneve. Duke parë uljen e shpenzimeve për mbrojtjen në pjesën më të madhe të Evropës, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, A. Rasmussen, i ka nxitur disa herë aleatët evropianë që t'i bashkojnë burimet e tyre për të përfituar nga ekonomitë e shkallës nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar (BBC, 2010; Mason, 2011). Bashkëpunimi mund të ketë natyrë financiare. Për shembull, më 15 dhjetor 2010 Estonia dhe Mbretëria e Bashkuar lidhën një marrëveshje kuadër për një blerje të përbashkët të pajisjeve të mbrojtjes, «duke hapur kështu rrugën për shkëmbimin e informacionit për blerjet e planifikuara ose të menduara të municioneve, armëve ose për mbrojtjen (Parlamenti Evropian, 2011, f. 64). Bashkëpunimi jo financiar mund të përfshijë shkëmbimin e informacioneve për blerjen e municioneve: një shembull i kohëve të fundit është memorandum i mirëkuptimit ndërmjet Organizatës së Materialeve të Mbrojtjes së Holandës (Dutch Defence Material Organization) dhe homologes së saj gjermane, Zyrës Federale për Teknologjinë dhe Prokurimet në Mbrojtje (Federal Office for Defence Technology and Procurement), e nënshkruar më 4 janar 2011. Marrëveshja nxit bashkëpunimin më të ngushtë në fushën e municioneve të kalibrit të mesëm dhe të madh dhe në të ardhmen mund të përfshijë edhe zhvillimin, testimin, blerjen dhe ruajtjen e municioneve. Përveç kësaj, të dhënat e testimin do të shkëmbehen lirshëm pa tarifa dhe të dyja organizatat do të jenë gjithashtu në gjendje të përdorin mjediset dhe pajisjet e testimin të njëra-tjetrës (MM e Holandës, 2011).

Në mënyrë ideale, bashkimi i burimeve dhe ndarja e përbashkët e kostove mund të konsiderohet pothuajse në çdo fazë të ciklit të jetëgjatësisë së pajisjes, përfshirë çmilitarizimin.

Përfundime

Për të eliminuar shumë nga rreziqet e sigurisë dhe mbrojtjes që lidhen me akumulimin e rezervave të tepërta të municioneve, që u ka skaduar afati i ruajtjes ose që janë potencialisht të paqëndrueshëm, autoritetet kombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe kompanitë industriale kanë zhvilluar një sërë procesesh të çmilitarizimit fizik për të trajtuar rezervat e tyre të tepërta dhe po i promovojnë ato në mënyrë aktive në vend të teknikave të tjera të asgjësimit. Megjithatë, kostot e çmilitarizimit të municioneve shpesh janë një barrë për qeveritë që janë ngushtë nga paratë. Kërkohen zgjidhje për t'i parashikuar dhe, nëse është e mundur, për t'i zvogëluar këto kosto.

Disa shtete mund të mendojnë se ulja e kostove të çmilitarizimit është vetëm një çështje negociimi për ofertën më të lirë në momentin e fundit nga industria e çmilitarizimit. Megjithatë, në praktikë kostot e çmilitarizimit trajtohen më mirë brenda kuadrit të një përqasjeje për «menaxhimin gjatë gjithë jetës», e cila integron kostot e gjeneruara nga municionet përgjatë gjithë ciklit jetësor të tyre: nga projektimi deri të prokurimi, ruajtja, përdorimi dhe çmilitarizimi.

Iniciativa të tilla si DfD-ja tregojnë gatishmërinë e një projektuesi për të përfshirë çështjet e çmilitarizimit që në fazat e hershme të ciklit jetësor të municioneve. Një staf i zgjuar prokurimesh në MM që kërkojnë të blejnë municione të reja konvencionale tani mund (dhe duhet) të kërkojë të dijë nëse dokumentacioni i blerjes përfshin kërkesat e projektit për çmilitarizimin dhe një plan çmilitarizimi ku përshkruhen procedurat, proceset dhe teknologjitë që duhet të përdoren.

Mund të bëhen shumë kursime edhe në një fazë të mëvonshme, p.sh. gjatë ruajtjes, duke implementuar një plan metodologjik të mbikëqyrjes së municioneve «në shërbim» për të monitoruar moshën, kohën e ruajtjes dhe gatishmërinë e përgjithshme të përdorimit të rezervave.

Njëkohësisht, mënyra më e sigurt që shtetet të ulin kostot e çmilitarizimit është që ta marrin në konsideratë çmilitarizimin vite përpara mbarimit të ciklit të jetëgjatësisë së rezervave. Planifikimi për çmilitarizim nënkupton marrjen e vendimeve në fazën më të

hershme të mundshme për t'i ndarë artikujt sipas përparësisë, për të përzgjedhur metodën e çmilitarizimit, për të optimizuar logjistikën dhe si përfundim një pjesë të procesit t'ia kontaktojnë kompanive të çmilitarizimit sipas kushteve më të mira të mundshme teknike dhe financiare. ■

Shënime fundore

- 1 «Çmilitarizimi» kuptohet si «gama e plotë e proceseve që i kthejnë armët, municionet dhe eksplozivët në të papërshtatshëm për qëllimin e tyre fillestar të përdorimit» (UNODA, 2011b, f. 8). Procesi përfshin operacionet e transportimit, ruajtjes, llogaritjes dhe para-përpunimit, si edhe procesin e shkatërrimit përfundimtar. «Asgjësimi» kuptohet si një proces më i gjerë që përfshin heqjen e municioneve dhe eksplozivëve nga rezervat me anë të një shumëllojshmërie metodash, të cilat jo domosdoshmërisht përfshijnë shkatërrimin. Forcat e armatosura në të gjithë botën tradicionalisht përdorin një ose më shumë nga gjashtë metodat e asgjësimit: (1) shitja, (2) dhurimi, (3) rritja e përdorimit në stërvitje, (4) hedhja në det të thellë, (5) groposja dhe (6) shkatërrimi ose çmilitarizimi (UNODA, 2011b, f. 9–10). Shitjet e sasive të tepërta janë trajtuar në botimet e mëparshme të RASR-së dhe Sondazhit për Armët e Vogla (shihni Gobinet and Gramizzi, 2011; Gobinet, 2011).
- 2 Intervistë e autorit me D. Towndrow, Agjencia e NATO-s për Mbështetje dhe Furnizim (NAMSA), 8 shkurt 2012.
- 3 PBX është një eksploziv i krijuar me derdhje që mund të shkëputet, por nuk mund të shkrihet.
- 4 Intervistë e autorit me A. Wilkinson, specialist dhe konsulent për municionet, 20 janar 2012.
- 5 Intervistë e autorit me D. Towndrow, (NAMSA), 8 shkurt 2012.
- 6 Intervistë e autorit me D. Towndrow, (NAMSA), 8 shkurt 2012.
- 7 Intervistë e autorit me D. Towndrow, (NAMSA), 8 shkurt 2012.
- 8 Intervistë e autorit me D. Towndrow, (NAMSA), 8 shkurt 2012.
- 9 Sipas Meyer, Köhler, and Homburg (2007, f. 136), rrjedhja është «ndarja e përbërësve vajorë nga eksplozivët gjatë ruajtjes së tezgjatur, sidomos në temperatura të larta. . . . Ruajtja e tezgjatur, sidomos në klimat e lagështa, mund të shkaktojë rrjedhjen e eksplozivëve me nitroglicerinë xhelatinoze. Tepër e rrezikshme është

rrjedhja e nitroglicerinës së palidhur; kjo ndodh kur xhelatinizimi me nitrocelulozë (tretësirë shpërthyes) nuk ka qenë i saktë ose kur nitroceluloza është e një cilësie të keqe.

- 10 Për shkak se propellantët nga vetë natyra janë kimikisht të paqëndrueshëm, atyre u shtohen lëndë stabilizuese për të ngadalësuar procesin e plakjes. Lënda stabilizuese do të kompensohet ngadalë dhe do të vijë një pikë kur të mos mjaftojë për të parandaluar dekompozimin e përsheptuar. Në këtë pikë propellanti mund të ndizet vetë.
- 11 Fosfori i bardhë, një substancë jashtëzakonisht toksike, shkrihet në temperaturën rreth 45°C.
- 12 Quhet gjithashtu edhe «mbikëqyrje në shërbim» (in-service surveillance – ISS). Sipas terminologjisë së Qendrës së NATO-s për Analizimin e Informacionit të Sigurisë së Municioneve (NATO Munitions Safety Information Analysis Centre), ISS-ja bën pjesë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e municioneve për procesin e menaxhimit të shërbimit dhe besueshmërisë (Sharp, n.d.).
- 13 Për shembull, sipas UNODA (2011d, f. 10), «shembulli më ekstrem i degradimit të qëndrueshmërisë kimike është ai i eksplozivëve me bazë ester nitrati, të cilët në fund të fazës së sigurt të jetës së tyre ndizen vetvetiu; zakonisht duke shkaktuar humbjen e një magazine. Shumica e propellantëve në armë dhe shumë raketa përmbajnë estere nitrati si nitroceluloza dhe nitroglicerina.»
- 14 Është e qartë që operacionet duhet të kryhen në ndërtesa të përshtatshme për përpunimin e municioneve dhe jo në depo magazinimi.
- 15 Për shembull, disa lloje municionesh dhe përbërësit e tyre duhet të digjen për të përfutur një copë metali që mund të klasifikohet pa eksploziv. Furra e djegies duhet të nxeht deri në rreth 500°C. Gjatë kësaj faze që kërkon shumë energji, niveli i prodhimit është zero. Me qëllim për të siguruar shpërblimin optimal, duhet të punohet pa pushim. Impiantet që drejtohen nga qeveria mund të mos jenë në gjendje ta arrijnë këtë.
- 16 Nxjerrja e copave të tepërta është heqja e pajisjeve të padetonuara dhe mund të minimizohet nga vendosja e duhur e mbushjeve të shumëfishta.
- 17 Sistemi individual i lëvizshëm i mbrojtjes kundërajrore.
- 18 Wilkinson and Watt (n.d., parag. 5) shpjegojnë se «nëse municionet

- konsiderohen si mallra të rrezikshëm, atëherë transportimi i tyre do të kryhet në përputhje me legjislacionin kombëtar bazuar në sistemin e klasifikimit të Kombeve të Bashkuara “Libri portokalli”». Nëse municionet klasifikohen si mbetje të rrezikshme, transportimi dhe magazinimi i tyre do t'i nënshtrohet rregulloreve shtesë dhe kërkesave për leje, të rregulluara nga agjencitë e mjedisit të shteteve të ndryshme. Me përjashtimin e raportuar të Suedisë, rregulloret e Bashkimit Evropian që parandalojnë transportimin e mbetjeve të rrezikshme në vendet në zhvillim aktualisht nuk zbatohen për municionet që transportohen për çmilitarizim në Evropë, ku, «njësoj si në SHBA, municionet ushtarake konsiderohen se rregullohen nga rregullore më të rrepta se mbetjet e rrezikshme» (Wilkinson and Watt, n.d., parag. 5.2).
- 19 Për të sponsorizuar programet për asgjësimin e armëve dhe municioneve, Komuniteti Evropian dhe Agjencia Evropiane e Mbrojtjes koordinojmë gjithashtu prokurimin e disa artikujve me vlerë të lartë, si p.sh. furrat djegëse (inceneratorët) e mbetjeve eksplozive.
- 20 AQAP: Botimet për Garantimin e Cilësisë së Aleatëve (Allied Quality Assurance Publications); AQAP 2130 është kërkesa e NATO-s për garantimin e cilësisë për inspektimin dhe testimin (NATO, 2003).

Bibliografia

- Administrata e Materialeve të Mbrojtjes në Suedi. 2010. 'Demilitarization Batch No. 11.' Kërkesa e datës 23 qershor 2010, referenca 358060 – A1811994. <<http://217.114.80.93/upload/Bilder%20och%20dokument/Upphandling/liand/A1811994.pdf>>
- BBC (Korporata Britanike e Transmetimeve). 2010. 'NATO Head Rasmussen "Concerned" over UK Defence Cuts.' Botim në internet, 7 nëntor. <<http://www.bbc.co.uk/news/uk-politics-11706423>>
- BE (Bashkimi Evropian). 2000. Direktiva 2000/76/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 dhjetor 2000 për Djegjen e mbetjeve. <<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32000L0076:en:HTML>>
- Bevan, James. 2008. 'Stockpile Management: Accounting.' Në botimin e James Bevan, *Conventional Ammunition in Surplus: A Reference Guide*. Gjenevë: Small Arms Survey, f. 49–60. <<http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/D-Book-series/book-05-Conventional-Ammo/SAS-Conventional-Ammunition-in-Surplus-Book-07-Chapter-5.pdf>>
- Buckley, Clyde, Sulev Suvari, dhe Eric Deschambault. 2009. 'Physical Security and Stockpile Management.' Prezantim në seminarin e parë të RASR-së. Zagreb, 5–7 maj. <<http://www.rasrinitiative.org/pdfs/workshop-1/RASR-PSSM.pdf>>
- Courtney-Green, Peter. 2009. 'An Explosive Situation.' *Defence Management Journal*, Nr. 47. <http://www.defencemanagement.com/article.asp?id=409&content_name=Demilitarisation&article=13652>
- Gobinet, Pierre. 2011. *Significant Surpluses: Weapons and Ammunition Stockpiles in South-east Europe*. Raporti special nr. 13. Gjenevë: Small Arms Survey. <<http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/C-Special-reports/SAS-SR13-Significant-Surpluses.pdf>>
- dhe Claudio Gramizzi. 2011. 'Scraping the Barrel: The Trade in Surplus Ammunition.' Përmbledhje e shkurtër nr. 2. Gjenevë: Small Arms Survey. Prill. <<http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/G-Issue-briefs/SAS-IB2-Scraping-the-barrel.pdf>>
- King, Benjamin and F. David Diaz. 2011. 'Preparing PSSM Programmes: Avoiding the Inevitable Problems?' Në botimin e Benjamin King *Safer Stockpiles: Practitioners' Experiences with Physical Security and Stockpile Management (PSSM) Assistance Programmes*. Gjenevë: Small Arms Survey, f. 8–47. <<http://www.smallarmssurvey.org/fileadmin/docs/B-Occasional-papers/SAS-OP27-Safer-Stockpiles.pdf>>
- MacBride, John. 2009. 'International Cooperation and Assistance.' In German Federal Foreign Office and Royal Norwegian Ministry of Foreign Affairs. *Berlin Conference on the Destruction of Cluster Munitions 25–26 June 2009*, f. 42–43. <http://www.berlin-ccm-conference.org/fileadmin/pdf/CCM_Berlin/CCM-Berlin-CompletePublication-Aug2009.pdf>
- Mason, Daniel. 2011. 'Do Defence Cuts Threaten Europe's Post-Libya NATO Role?' Public Service Europe, 31 gusht. <<http://www.publicserviceeurope.com/article/779/do-defence-cuts-threaten-europes-post-libya-nato-role>>
- Mescavage, Gary. 2010. 'Implementation of Design for Demil (DFD) in the Joint Services.' Dokument i paraqitur në Simpoziumin Global për Çmilitarizimin (Global Demilitarization Symposium). Denver, Kolorado, 17 maj. <https://tpm.dac.army.mil/events/Docs/2011GDS/GS-A_10.pdf>
- Meyer, Rudolf, Josef Köhler, and Axel Homburg. 2007. *Explosives*, Botimi i 6-të i rishikuar Wiley-VCH Verlag GmbH & Co. KGaA. <<http://miningandblasting.files.wordpress.com/2009/09/explosives-6th-edition-by-meyer-kohler-and-homburg-2007.pdf>>
- Ministria e Mbrojtjes e Holandës. 2011. 'Ammunition Agreement with Germany Saves Money.' 12 janar. <http://www.defensie.nl/english/latest/news/2011/01/12/48177416/Ammunition_agreement_with_Germany_saves_money>
- NAMSA (NATO Maintenance and Supply Agency). 2009. *NAMSA Procurement Regulations*. Rregullorja e NAMSA-s Nr. 251-01. Rish. 1, përfshirë ndryshimet 2. 19 qershor. <<http://www.namsa.nato.int/pdf/nr-251-01e.pdf>>
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior). 2003. *Kërkesat e NATO-s për garantimin e cilësisë për inspektimin dhe testimin*. <<http://www.namsa.nato.int/pdf/AQAP2130e.pdf>>
- Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO – International Maritime Organization). n.d. Konventa për parandalimin e ndotjes së deteve nga hedhja e mbeturinave dhe materialeve të tjera (LC), 1972 (dhe Protokollit i Londrës i vitit 1996). <<http://www.imo.org/About/Conventions/ListOfConventions/Pages/Convention-on-the-Prevention-of-Marine-Pollution-by-Dumping-of-Wastes-and-Other-Matter.aspx>>
- Park, Jason, John Eng, and George Garrard. 2011. 'An Update of Policy and Legislation as it Pertains to the Disposal/Demilitarization of Ammunition and Explosives in the DND/CF.' Prezantim në simpoziumin për Asgjësimin e municioneve dhe propellantëve dhe ndikimin e tij në mjedis. Edinburg, 17–20 tetor.
- Parlamenti i BE-së (Bashkimi Evropian). 2011. *Impakti i krizës financiare në mbrojtjen evropiane: Shtojca*. Departamenti i Politikave, Drejtoria e Përgjithshme për Politikat e Jashtme. EXPO/B/SEDE/FWC/2009-01/LOT6/11 prill. <<http://www.europarl.europa.eu/document/activities/cont/201106/20110623ATT22406/20110623ATT22406EN.pdf>>
- PM për Çmilitarizimin (Menaxheri i projektit për çmilitarizimin). 2009. Demilitarization Enterprise Strategic Plan. 15 qershor. <<https://peoammo.army.mil/PMJointServices/Documents/DemilStrategicPlan2009-06-09Final.pdf>>

- Raftery, Brian. 2008. 'Conventional Ammunition Demilitarization (Demil)—A Growing Challenge.' *ARMY AL&T*, 2008. Vëll. Janar-Mars, 01, f. 38-41. <http://asc.army.mil/docs/pubs/alt/2008/1_JanFebMar/articles/38_Conventional_Ammunition_Demilitarization_%28Demil%29--_A_Growing_Challenge_200801.pdf>
- Sharp, Michael. n.d. 'In-service Surveillance.' Prezantim në PowerPoint, Qendra e NATO-s për Analizimin e Informacionit të Sigurisë së Municioneve.
- Shoqata e Ushtrisë së SHBA-së. 2008. *Disposal of Excess, Obsolete and Unserviceable Ammunition: Help for the Warfighter*. Buletini, gusht. <http://www.ousa.org/publications/torchbearercampaign/torchbearerissuepapers/Documents/TBIP_081808.pdf>
- Towndrow, David. 2009. 'Environmentally Responsible Munition Systems.' Broshurë e pabotuar për *MOD Sustainable Development and Environment Manual* (Manuali i MM për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mjedisin. JSP 418, Vëll. 2.
- UNGA (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara). 2008. *Problems Arising from the Accumulation of Conventional Ammunition Stockpiles in Surplus*. Raport i Grupit të Ekspertëve Qeveritarë. A/63/182 datë 28 qershor 2008. <<http://www.poa-iss.org/CASAUpload/ELibrary/A-63-182.pdf>>
- UNODA (Zyra e Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit). 2011a. 'Demilitarization and Destruction of Conventional Ammunition.' Udhëzimet teknike ndërkombëtare për municionet IATG 10.10. <http://www.un.org/disarmament/convarms/Ammunition/IATG/docs/IATG10.10-Demilitarization_and_Destruction%28V.1%29.pdf>
- . 2011b. 'Glossary of Terms, Definitions and Abbreviations.' Udhëzimet teknike ndërkombëtare për municionet IATG 01.40. <http://www.un.org/disarmament/convarms/Ammunition/IATG/docs/IATG01.40-Glossary_and_Definitions%28V.1%29.pdf>
- . 2011c. 'Surveillance and In-service Proof.' Udhëzimet teknike ndërkombëtare për municionet IATG 07.20. <http://www.un.org/disarmament/convarms/Ammunition/IATG/docs/IATG07.20-Surveillance_and_In-Service%20Proof%28V.1%29.pdf>
- US GAO (Zyra e Kontrollit të Përgjithshëm e Shteteve të Bashkuara (United States General Accounting Office). 1996. *Defense Ammunition: Significant Problems Left Unattended Will Get Worse*. Uashington, DC. 21 qershor. GAO/NSIAD-96-129. <<http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/GAOREPORTS-NSIAD-96-129/pdf/GAOREPORTS-NSIAD-96-129.pdf>>
- Wilkinson, Josh dhe Duncan Watt (n.d.) *Review of Demilitarisation and Disposal Techniques for Munitions and Related Materials*. Bruksel: Selia Qendrore e NATO-s, Qendra e Analizimit të Informacionit të Sigurisë së Municioneve. <<http://ftp.rta.nato.int/public/PubFullText/RTO/TR/RTO-TR-AVT-115/TR-AVT-115-ANN-A-Files/TR-AVT-115-ANN-A-11.pdf>>
- Young, John. 2008. 'Design for Demilitarization of Conventional Ammunition.' Uashington, DC. 4 gusht. <<https://peoammo.army.mil/PMJointServices/Documents/2008-4856-ATLSignedDfdDodPolicy.pdf>>

Lidhur me Sondazhin për Armët e Vogla

Sondazhi për Armët e Vogla shërben si burimi kryesor ndërkombëtar për publikun lidhur me aspektet e armëve të vogla dhe dhunës me armë, dhe si një qendër burimore për qeveritë, politikëbërësit, studiuesit, dhe aktivistët. Sondazhi i përcjell gjetjet e tij përmes Raporteve të Veçanta, Librave në Seri dhe botimit të tij kryesor të përvitshëm, që është *Sondazhi për Armët e Vogla*.

Projekti ka një staf ndërkombëtar me ekspertizë në studime të sigurisë, shkencë politike, politikë publike ndërkombëtare, juridik, ekonomi, studime zhvillimi, zgjidhje konfliktesh, sociologji dhe kriminologji, dhe bashkëpunon ngushtë me një rrjet ndërkombëtar studiuesish dhe partnerësh.

Sondazhi për Armët e Vogla është projekt i Institutit Studimor të Studimeve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit (Graduate Institute of International and Development Studies) në Gjenevë. Për më shumë informacion, shihni www.smallarmssurvey.org

Rreth Nismës së Përjasjes Rajonale për Reduktimin e Rezervave të Tepërta (RASR)

Përjasja Rajonale për Reduktimin e Rezervave (RASR) është një përjasje rajonale afatgjatë dhe e koordinuar që do t'u gjejë zgjidhje kërcënimeve që paraqesin rezervat e tepërta, të paqëndrueshme dhe të pasiguruara ose ndryshe të rrezikuara të armëve konvencionale dhe municioneve.

RASR nxit qeveritë e prekura dhe organizatat përkatëse që të zhvillojnë një përjasje rajonale proaktive dhe të koordinuar për të siguruar dhe shkatërruar armët e vogla dhe armët e lehta, duke krijuar kapacitetet lokale, duke shkëmbyer praktikat më të mira

dhe mësimet e nxjerra, si dhe duke sinkronizuar burimet për të maksimizuar efikasitetin e tyre.

Qëllimi përfundimtar i nismës RASR është parandalimi i shpërthimeve katastrofike dhe devijimeve destabilizuese të armëve konvencionale dhe municioneve.

Financimi për këtë Përmbledhje të shkurtër është siguruar nga Zyra për Heqjen dhe Pakësimin e Armëve (Office of Weapons Removal and Abatement) pranë Departamentit të Shtetit të SHBA-së.

Për më shumë informacion shihni www.rasrinitiative.org.

Kreditet

Autorët: Pierre Gobinet dhe Tom Van Beneden

Redaktor: Alex Potter (fpcc@mtloaded.co.za)

Korrektor: John Linnegar

Grafika dhe faqosja: Richard Jones (rick@studioexile.com)

Albanian version

Detajet e kontaktit

Small Arms Survey

47 Avenue Blanc

1202 Gjenevë, Zvicër

t +41 22 908 5777 f +41 22 732 2738

